

553/26 10-07-2026



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës (nr.6320/15 i datës 22.10.2015), nenit 34 të Kodit të Etikës nr.01/2022/KG të Komunës së Graçanicës (Nr.3041/22 i datës 14.06.2022), Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të rregullt të mbajtur më datën 10.02.2026, merr këtë:

V E N D I M Nr.04/2026/KG
për formimin e Komisionit të Etikës së Komunës së Graçanicës

Neni 1

Formohet Komisioni i Etikës së Komunës së Graçanicës.

Neni 2

Për anëtarë të Komisionit të Etikës emërohen personat e mëposhtëm:

1. Ljubisha Karaxhiq (*Ljubiša Karadžić*), anëtar (propozim nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Komunal)
2. Milla Zhivkoviq (*Mila Živković*), anëtare (propozim nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Komunal)
3. Brankica Ničić, anëtare (propozim nga radhët e personave të emëruar)
4. Nebojsa Rashiq (*Nebojša Rašić*), anëtar (propozim nga radhët e qytetarëve me integritet)
5. Ljubomir Maksimoviq (*Ljubomir Maksimović*), anëtar (propozim nga radhët e qytetarëve me integritet)

Neni 3

Kryesuesin e Komisionit të Etikës e zgjedhin anëtarët e komisionit nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Graçanicës.

Neni 4

Komisioni i Etikës është i detyruar që t'i kryej detyrat e tij në përputhje me dispozitat e Kodit të Etikës Nr.01/2022/KG të Komunës së Graçanicës (Nr.3041/22 i datës 14.06.2022).

Neni 5

Anëtarët e Komisionit të Etikës i kryejnë detyrat e tyre pa kompensim.

Neni 6

Anëtarët e Komisionit të Etikës kanë mandat deri në skadimin e mandatit të rregullt ligjor të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, me përjashtim të rasteve të shkarkimit/dorheqjes së mëhershme.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević